6

**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike**

Datë 10.06.2025

**RAPORT VENDIMMARRJEJE**

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT NR. 30, DATË 26.03.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1032 RRUGA "ALEKS KOMNENI" DHE PALLATIN "KASTRATI" RRUGA "RAMADAN VELIU" TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019" TË NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET MIRATIMIT TË SIPËRFAQEVE SHTESË.**

**Baza ligjore:**

Neni 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligji nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhër nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit" i ndryshuar.

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër** *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Komisioni i Posaçëm, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.30, datë 26.03.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve nga procesi i rindërtimit për pallatin nr.1032, rruga "Aleks Komneni" dhe pallatin "Kastrati", rruga "Ramadan Veliu", të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019", përsa i përket miratimit të sipërfaqeve shtesë nga diferenca në m2 të përfituara nga subjektet përfituese me vendimet përkatëse, sipas Listës së subjekteve përfitues me përbërjen familjare,

strukturën e apartamentit si dhe m2, hartuar nga Komisioni i Posaçëm dhe kjo listë përbën pjesë integrale të këtij projekt-vendimi.

**Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

Fonde nga subjekt privat.

**Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Komisioni i Posaçëm.

**Impakti social/grupet që preken:**

Banorët e pallatit nr.1032, rruga "Aleks Komneni" dhe pallatin "Kastrati", rruga "Ramadan Veliu".

**A është objekt konsultimi:** *(PO/JO)*

*JO.*

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, u mblodhë më datë 10.06.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 6 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Flutura: Kastrati ka bërë një ankim e vërejtje dhe ka një listë me 137 banorë që do të përfitonin. Përse 18 po hiqen. Përse mungojnë 18 familje. Genti: Kastrati ka sjellë listën që i ka ai banorët në pallat por Bashkia trajton përfituesit sipas kritereve që përcaktohen në kuadrin ligjor. Ka raste të cilat banorët kanë rezultuar me dy apartamente dhe nuk mund të përfitojnë dy apartamente dhe me 81 ligjin nuk mund të japë strehim. Alketa: Apartamentet që mbeten do të kalojnë Bashkisë e cila do të menaxhojë.

---

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:**

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
e- ______________________________

**Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Kryetar | Marsida Feshti |
| 2 | Zv/Kryetar | Sami Osmani |
| 3 | Sekretar | Joniada Musaraj |
| 4 | Anëtar | Dorian Isaj |
| 5 | Anëtar | Elisabeta Mataj |
| 6 | Anëtar | Flutura Kasa |
| 7 | Anëtar | Edlira Shemsi |
| 8 | Anëtar | Kontjana Kuçi |
| 9 | Anëtar | Erald Dalipi |

Përfaqësues nga Bashkia:
Almeida Roshi
Gentian Kallmi: